



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News:

DVP Fier/Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 4 të tjerë, për vepra penale të ndryshme
DVP Korçë/Procedohen në gjendje të lirë 3 shtetas, për vepra të ndryshme penale
Fier/Kishte përgatitur doza kokaine, për t'i shitur në qytetin e Roskovecit, arrestohet 37-vjeçari
DVP Elbasan – Vihen në pranga 2 shtetas, procedohen në gjendje të lirë 3 të tjerë
DVP Shkodër/Procedohen në gjendje të lirë 3 shtetas, për vepra penale të ndryshme



Lajmet

22/01/2024

Gjirokastrë/Vihet Në Pranga 1 Shtetas Dhe Procedohen Në Gjendje Të Lirë 3 Shtetas Të Tjerë, Për Vepra Penale Të Ndryshme

Gjirokastrë/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 3 shtetas të tjerë, për vepra penale të ndryshme.

Specialistët e Seksionit të Trafikut Interurban arrestuan në flagrancë shtetasi H. Ç., 66 vjeç, banues në Vlorë, pasi u kap duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur.

Po nga këto struktura u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin K. D., 24 vjeç, banues në fshatin Asim Zeneli, Gjirokastrë, pasi ditën e djeshme, në rrugën “18 shtatori”, me automjetin që drejtonte, ka aksidentuar një 87-vjeçar (këmbësor), banues në Gjirokastrë, i cili është jashtë rrezikut për jetën.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Përmet referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin Q. M., 19 vjeç, banues në Përmet, pasi gjatë kontrollit fizik iu gjet një mjet prerës (thikë), i cili u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Gjirokastrë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin A. B., 54 vjeç, banues në Bubullimë, Lushnjë, pasi në PKK Kakavije, në hyrje, gjatë kontrollit në çantën e tij, shërbimet e Policisë kanë gjetur 8 pako me fishekë për armë gjahu, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)